



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:027603

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05556979

**C.nr.28/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. B. nga ....., të cilin e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Kamenicë, me objekt kontesti kompensim i diferencës së pagës në bazë të kualifikimit-licencimit, me vlerë të objektit të kontestit prej 2,623.86 euro, jashtë seancës gjyqësore më datën 06.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. B. nga ....., dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Kamenicë që paditësit në emër të kërkesës për kompensim të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit – lëvizje në gradim-fakultet që përcillet me ngritje page 27 % të pagës bazë për 26 muaj, t’ia paguaj shumën nga 61.00 euro, për një muaj, respektivisht shumën prej 1,586.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (datë 17.01.2024) e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit më tepër se shuma e gjykuar si në dispozitivin I, edhe atë, shuma prej 1,037.86 euro në emër të diferencës në pagë për 17 muaj, **REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

**III. DETYROHET** e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguaj paditësit shumën 144.00 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, në këtë gjykatë më datë 17.01.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për

kompensimin e diferencës në pagë për punonjësin me Licencim. Në përmbajtjen e padisë i njëjti ka theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura. Më tej ka shtuar se paditësja fillimisht i është drejtuar të paditurës, ku ka kërkuar kompensimin e diferencës me Licencim, mirëpo të njëjtit nuk janë përgjigjur. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës të aprovuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 €, për përpilim të padisë; 40.00 € për taksë gjyqësore, apo shumën e përgjithshme në shumën prej 144.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar duke theksuar se e paditura nuk ka legjitimitet real pasiv për faktin se për zbatimin e Vendimit Nr.01/33 të datës 29.08.2008, shprehimisht në pikën 8 të këtij vendimi është përgjegjëse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike, duke shtuar se me qëllim të implementimit të vendimeve të Qeverisë, një shumë e caktuar financohet nga niveli komunal, kurse pjesa tjetër nga niveli qendror.

Gjykata ka vlerësuar parashkrimin e kërkesës bazuar në kundërshtimin e të paditurës, por ka gjetur se periudha kohore e kërkuar për këtë kompensim për vitin 2020 është përfshirë në poarashkrim, ndërsa për vitin 2021 e deri në shkurt të vitit 2023 nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 17.01.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga data 01.01.2021 (më saktësisht 2 vite).

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënjen e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jepë aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura (fakt i vërtetuar edhe nga Kontrata e punës me nr. të prot. 5595, e datës 02.03.2021, nuk është kontestues fakti se i njëjti punon në këtë shkollë, nuk është kontestues fakti se e njëjta ka të kryer Fakultetin Filozofik, dhe mori titullin bachelor i psikologjisë, nuk është kontestues fakti se i njëjti ka pagën bazë 391.25 euro (fakt ky i vërtetuar nga Lista e Buxhetit të Republikës së Kosovës).

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë*

*përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura.*

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 7 të kësaj Kontrate, si dhe Mendimit Juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Sipas nenit 2 parag.1 dhe 2 të Ligjit të punës, është paraparë se “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”, kurse sipas 90 të këtij ligji, është paraparë se: *“1.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”,* ndërsa me nenin 4, parag. 2 të po këtij ligji, është paraparë se: *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”,* e po ashtu lidhur me këtë sipas nenit 3 parag.1 pika 1.8 i këtij ligji ka paraparë se *shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim “Kontrata kolektive është marrëveshje ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”* kurse me pikën. 1.11 të po këtij paragrafi është paraparë se *“Kontrata e punës është akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.* Sipas nenit 8 parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”.* Kurse sipas nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së

Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), është paraparë se: “*Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit sipas pikës 1.3 të këtij neni është paraparë se mësimëdhënësi me diplomë fakulteti 27 % e pagës bazë*”.

Gjykata gjeti se paditësit i takon kompensimi i pagesës për gradim–diferencë në bazë të Vendimi i Qeverisë, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, si dhe Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Vitisë, ashtu që gjykata të njëjtit i ka aprovuar shumën e kërkuar që përcillet me ngritje page 35% të pagës bazë për periudhën të përshkruar si në pikën I të dispozitivit. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë për shumën e gjykuara dhe të aprovuara, gjykata ka vendosur pa nxjerrë ekspertizë përkatëse për shkak të ekonomizmit të procedurës ngase shumat ishin lehtë të kalkulueshme dhe të qarta për gjykatën.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të parashtruar me përgjigjen në padi se KKAK nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, për gjykatës një pretendim i tillë është i pabazuar nga fakti se në bazë të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr.214/2013 të dt.09.10.2023 dhe nenit 7 të Kontratës Kolektive ku parashihen gradimet dhe Vendimit nr.1/33 të vitit 2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i cili ka qenë në fuqi deri më datën 06.02.2023, dispozita e lartcekur e nenit 7 ka karakter detyrues.

Përgjegjësinë e të paditurës, gjykata e gjeti edhe nga neni 245 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin është përcaktuar se “Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, pasi me rastin e nënshkrimit të KKA-së, e paditura ka hyrë në marrëdhënie të detyrimeve me të punësuarit e saj.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar të bazuar kërkesëpadinë paditësit për kompensimin e licencimit-kualifikimit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar shumën prej 1,037.86 euro në emër të diferencës në pagë për 17 muaj (për vitin 2020), sepse gjeti se e njejta kërkesë është parashkruar, kurse per vitin 2023, kompensimi në emër të diferencës njihet vetëm për muajt janar dhe shkurt, ashtu që gjykata refuzoi shumën përtej dispozitivit I të këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendosjen për kamatën, gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, por që e ka marrë konsideratë edhe Mendimin Juridik për kamatën (lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes) të Gjykatës Supreme, nr.265/2020, të datës 02.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ashtu që ia njohi kërkesën e shpenzimeve sa i përket përpilimit të padisë dhe taksës gjyqësore, si shpenzime të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega në Kamenicë**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.28/24, datë 06.03.2024**

**Gjyqtari,**  
**Artan Abazi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.